



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT, FORMIMIT PROFESIONAL DHE
KUALIFIKIMEVE**

**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMET PËRFUNDIMTARE
KUALIFIKIMI PROFESIONAL “Pyje”**

(Niveli II në KSHK, referuar niveli II në KEK)

Kodi: S-II-23

Tiranë, 2025

Programi orientues për provimet përfundimtare të kualifikimit profesional “Pyje”, **Niveli II në KSHK, referuar niveli II në KEK**, përmban temat dhe kompetencat më të rëndësishme dhe më përfaqësuese për këtë kualifikim profesional, të trajtuara në lëndët profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale në klasat e këtij niveli, të cilat do të shërbejnë si bazë për të konceptuar provimet teorike dhe praktike përkatëse.

Ky program i ndihmon individët të përqendrohen në ato njohuri (koncepte, parime, ligjësi, procedura etj.) dhe kompetenca profesionale, që qëndrojnë në themel të profesionit për këtë nivel kualifikimi. Programi ndihmon, gjithashtu, edhe mësimdhënësit për organizimin e punës në përgatitjen për kontrollin përfundimtar të arritjeve të individëve.

Për drejtuesit e shkollave profesionale, këto programe krijojnë mundësinë për planifikimin dhe realizimin e Provimeve Përfundimtare në nivel shkolle.

Gjatë punës me këto programe kujdes duhet t’i kushtohet përvetësimit të njohurive dhe kompetencave themelore për këtë nivel kualifikimi, të cilat bëjnë të mundur integrimin e individit në botën e punës, por edhe që krijojnë vazhdimësinë e shkollimit të tij/saj në nivelin tjetër.

Gjatë përgatitjes së individëve për provimet përfundimtare të niveleve, është e rëndësishme që paraprakisht mësimdhënësit të zhvillojnë testime të nxënësve, me teste teorike apo praktike, të cilat mund t’i hartojnë vetë, duke përdorur instrumente vlerësimi në përputhje me kërkesat e këtij dokumenti. Gjatë hartimit të përmbajtjes së tyre duhen mbajtur parasysh njohuritë dhe kompetencat e përfshira në këtë program, kriteret e vlerësimit të përcaktuara në modulet përkatëse si edhe udhëzimet për vlerësimin e nxënësve.

Programi orientues përbëhet nga dy pjesë:

- Programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar
- Programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar

A) Programi orientues për Provimin e Teorisë Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e teorisë profesionale të integruar, në kualifikimin profesional “Pyje” **Niveli II në KSHK, referuar niveli II në KEK** është hartuar duke u mbështetur në temat më të rëndësishme të programeve të lëndëve profesionale më përfaqësuese dhe më thelbësore, të cilat përbëjnë 35 % të vëllimit të përgjithshëm të lëndëve profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

Lëndët profesionale të përzgjedhura për t’u përfshirë në provimin e teorisë profesionale dhe temat e përzgjedhura në të, janë si më poshtë:

Lënda dhe pesha përkatëse në programin orientues:

Nr.	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Fidanishte pyjore	63 orë	29
2	Shfrytëzim i pyjeve	27 orë	12
3	Silvikulturë	60 orë	27
4	Dendrometri	38 orë	17
5	Mbrojtja e pyjeve	33 orë	15
	TOTALI	221 orë	100%

1) Temat nga lënda “**Fidanishte pyjore**”, kl. 10-të :

Gjithsej 63 orë

Tema 2	Klasifikimi dhe zgjedhja e drurëve	7 orë
Tema 3	Klasifikimi dhe zgjedhja e grumbujve farorë	7 orë
Tema 4	Treguesit cilësorë e sasiorë të farërave	10 orë
Tema 5	Veçoritë e mbjelljes së farërave	5 orë
Tema 6	Veçoritë e përgjithshme të fidanishteve pyjore	3 orë
Tema 7	Kriteret dhe procedurat e mbjelljes së farërave në fidanishte	28 orë
Tema 8	Prodhimi i fidanëve me kalema	3 orë

2) Temat nga lënda “**Shfrytëzim i pyjeve**”, kl.10-të:

Gjithsej 27 orë

Tema 2	Fazat e procesi teknologjik të shfrytëzimit të pyjeve	5 orë
Tema 3	Punimet përgatitore për shfrytëzimin e ngastrave pyjore, punimet dhe mjetet që përdoren. Organizimi i punës dhe sigurimi teknik	4 orë
Tema 4	Mjetet dhe teknikat për rrëzimin e drurëve, asortimin dhe standardet e lëndës drusore	4 orë
Tema 5	Mjetet të thjeshta të dorës dhe mekanizmat kryesore në punimet e shfrytëzimit të pyjeve	5 orë
Tema 6	Njohuri të përgjithshme për motosharrat	4 orë
Tema 7	Transporti i brendshëm i materialit drusor, mjetet dhe mekanizmat kryesore	5 orë

3) Temat nga lënda “**Silvikulturë**”, kl.11-të:

Gjithsej 60 orë

Tema 2	Njohuri të përgjithshme mbi pyllin	5 orë
Tema 3	Drunishtja, karakteristikat e saj	11 orë
Tema 4	N/drunishtja, filizëria dhe shtesa barishtore	5 orë
Tema 5	Raportet ndërmjet pyllit dhe mjedisit rrethues	2 orë
Tema 6	Raportet ndërmjet pyllit dhe faktorit klimatik	17 orë
Tema 7	Raportet ndërmjet pyllit dhe faktorit tokësorë	6 orë
Tema 8	Raportet ndërmjet pyllit dhe faktorit reliev dhe atij biotik	6 orë

Tema 9	Ripërtëritja, rritja dhe zhvillimi i pyllit	8 orë
--------	---	-------

4) Temat nga lënda “**Dendrometri**”, kl.11-të:

Gjithsej 38 orë

Tema 3	Instrumentet matës	8 orë
Tema 4	Kubimi i drurit të rrëzuar	12 orë
Tema 5	Kubimi i drurit në këmbë	7 orë
Tema 7	Kubimi i grumbujve pyjorë	11 orë

5) Temat nga lënda “**Mbrojtja e pyjeve**”, kl.11-të:

Gjithsej 33 orë

Tema 2	Mbrojtja e pyjeve nga dëmtimet që shkaktojnë kushtet e këqija stacionale të klimës dhe të tokës	2 orë
Tema 3	Zjarret në pyje, llojet, masat për parandalimin e tyre	2 orë
Tema 4	Njohuri mbi sëmundjet në pyje. Fitopatologjia pyjore	14 orë
Tema 5	Entomologjia pyjore. Dëmtuesit primarë dhe sekondare të pyjeve	12 orë
Tema 6	Metodat e mbrojtjes së pyjeve	3 orë

Udhëzime për përgatitjen e testit të provimit të teorisë profesionale:

Provimi i teorisë profesionale të integruar do të jetë me test me shkrim, i cili zgjat 1.5 (një presje pesë) dhe përgatitet nga Komisioni i Provimit Përfundimtar i kualifikimit profesional të nivelit përkatës. Për hartimin e testit komisioni mund të mbështetet edhe tek banka e testeve e përgatitur nga AKAFPK-ja. Në hartimin e testit komisioni duhet të mbajë parasysh rregullat, parimet dhe formatet, për ndërtimin e testit.

Testi duhet të përmbajë 30 njësi testi me një total prej 60 pikë. Nga këto, 20 njësi testi të jenë me zgjedhje të shumëfishtë (4 alternativa) dhe 10 të tjerat të jenë njësi testi me përgjigje të kufizuara/të mbyllura (me PO/JO; me e Vërtetë e Gabuar; me plotësim të fjalës që mungon; etj.) Testi duhet të shmang pyetjet e hapura.

Njësitë e testit duhet të jenë të niveleve të ndryshme të vështirësisë, duke ndjekur skemën me tre nivele, si më poshtë:

Niveli I (i ulët)	Niveli II (mesatar)	Niveli III (i lartë)
Aftësia për të rikujtuar/kuptuar/identifikuar dhe për të përshkruar...	Aftësia për të zbatuar/argumentuar/shpjeguar/krahasuar dhe për të analizuar...	Aftësia për të vlerësuar dhe për të nxjerrë përfundime...

Ndarja e pikëve sipas peshës së çdo lënde dhe niveleve

Nr.	Lënda	Peshat e lëndëve në %	Pikët për çdo lëndë	Ndarja e pikëve sipas niveleve të vështirësisë		
				Niveli I 40% e pikëve	Niveli II 40% e pikëve	Niveli III 20% e pikëve
1	Fidanishte pyjore	29	18	7	7	4
2	Shfrytëzim i pyjeve	12	7	3	3	1
3	Silvikulturë	27	16	6	6	4
4	Mbrojtja e pyjeve	17	10	4	4	2
5	Dendrometri	15	9	4	4	1
	TOTALI	100%	60 pikë	24 pikë	24 pikë	12 pikë

Përcaktimi i pikëve për çdo njësi testi bëhet duke pasur parasysh tipin e njësisë së testit. Për shembull: njësitë e testit me zgjedhje të shumëfishtë marrin gjithmonë 1 (një) pikë përkundërt përgjigjes së paracaktuar të saktë; njësitë me përgjigje të hapur marrin aq pikë sa kërkesa kanë brenda tyre (duke mbajtur parasysh edhe argumentimin nga nxënësi); njësitë me përgjigje të kufizuar marrin aq pikë sa gjykohet nga grupi hartues dhe kjo lidhet me kërkesat që parashtrihen në pyetje dhe niveli i vështirësisë.

Së fundi, skema e vendosjes së notës kundrejt pikëve të fituara përcaktohet nga grupi hartues i testit. Në vijim, jepet një model i skemës së vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 - 10	4
11 - 15	5
16 - 20	6
21 - 30	7
31 - 40	8
41 - 50	9
51 - 60	10

B) Programi orientues për Provimin e Praktikës Profesionale të integruar

Programi orientues për provimin e praktikës profesionale të integruar, në kualifikim profesional “Pyje” Niveli II në KSHK, referuar niveli II në KEK, është hartuar duke u mbështetur në listën e kompetencave profesionale dhe në modulet e detyruara të praktikës profesionale, që përmban Skeletkurrikuli përkatës.

Lista e kompetencave profesionale për të cilat duhet të vlerësohen nxënësit, **detyrat e punës** dhe **pikët** për secilën kompetencë janë si më poshtë:

Nr	Kompetencat profesionale	Detyrat e punës	Pikët
1.	Kryerja e proceseve të punës për mbjelljen e farës në fidanishten	Detyra 1: Vlerësimi i një ose më shumë prej proceseve të punës në mbjelljen e	20

	pyjore.	farës në fidanishten pyjore, në bazë të procedurave përkatëse.	
2.	Kryerja e proceseve të punës për rrëzimin e drurit	Detyra 2: Vlerësimi i një ose më shumë prej proceseve të punës për rrëzimin e drurit sipas procedurës përkatëse	20
3.	Kryerja e proceseve të punës për përcaktimin e llojeve pyjore të zonës së dafinës (lauretum),	Detyra 3: Vlerësimi i një ose më shumë prej proceseve të përcaktimit të llojeve pyjore në zonën e dafinës (Lauretum), karakteristikat morfologjike të tyre.	20
4.	Kryerja e proceseve të punës për matjen e diametrit dhe lartësisë së drurit me instrumentet përkatëse.	Detyra 4: Vlerësimi i një ose më shumë prej proceseve të matjes së drurëve me diametër matës dhe hipsometër.	20
5.	Kryerja e proceseve të punës për kultivimin e bimëve eterovajore.	Detyra 5: Vlerësimi i një ose më shumë prej proceseve të kultivimit të bimëve eterovajore.	20
Shuma			100

Skema e vlerësimit me nota:

Pikët e fituara	Notat
0 - 40	4
41 - 50	5
51 - 60	6
61 - 70	7
71 - 80	8
81 - 90	9
91 - 100	10

Shënime:

- Provimi praktik do të realizohet me anë të metodës së vlerësimit të nxënësve në “*poste pune*”, grupe pune ose në mënyrë individuale, në mjedise të shkollës (kopësht), fidanishte pyjore etj.
- Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se 3 orë, në përputhje kjo me Rregulloren e Zhvillimit të Provimeve Përfundimtare në fuqi. Koha për realizimin e të gjitha detyrave duhet të jetë jo më shumë se 3 orë, në përputhje kjo me Udhëzimin për organizimin dhe zhvillimin e provimeve në AFP.
- Në çdo detyrë respektimi i rregullave të sigurimit teknik dhe mbrojtjes së mjedisit duhet të jenë të përfshira në vlerësim.
- Në vlerësimin e kompetencave profesionale, rekomandohet t’i lihet hapësirë për vlerësim dhe bashkëbisedimit profesional ndërmjet anëtarëve të komisionit dhe nxënësit, pasi ai është element i rëndësishëm i secilës prej kompetencave të listuara. Komisioni i vlerësimit duhet të hartojë paraprakisht pyetjet për bashkëbisedimin profesional.
- Nxënësit duhet të punojnë në mënyrë të pavarur, pa ndërhyrjen e komisionit duke u testuar/vlerësuar në një nga proceset e punës për çdo detyrë, kjo edhe për shkak të kohës së kufizuar 3 orë të provimit praktik.

- Për çdo detyrë, komisioni i vlerësimit duhet të përgatisë instrumentet përkatëse të vlerësimit sipas kompetencave profesionale. Instrumenti i vlerësimit për secilën detyrë duhet të përfshijë të gjitha hapat e realizimit të saj, duke filluar nga përgatitja e vendit dhe mjeteve të punës, higjienizimin e vendit dhe mjeteve të punës, përgatitjes materialeve dhe atyre ndihmëse. Instrumenti i vlerësimit duhet të përfshijë në përmbajtjen e tij edhe kritere për vlerësimin e kompetencave kyçe profesionale si vetëkontrolli, përgjegjshmëria, manifestimi i guximit, angazhimi fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme. Gjithashtu, komisioni duhet të hartojë dhe një listë kriteresh vlerësimi.
- Për çdo detyrë komisioni duhet të përgatisë udhëzuesin e përmbushjes për nxënësit, ku do të jepen hapat për realizimin e detyrës përkatëse.
- Gjithashtu, është e rëndësishme që të përgatitet një material udhëzues i cili do t'u jepet nxënësve para fillimit të provimit, ku të përfshihen të gjitha udhëzimet për kryerjen e provimit të praktikës profesionale.

Për realizimin e **Detyrës 1**: **“Vlerësimi i një ose më shumë prej proceseve të punës në mbjelljen e farës në fidanishten pyjore, në bazë të procedurave përkatëse”**

Nxënësi duhet të testohet për një proces pune, për mbjelljen e farës në fidanishte, si: (të zgjedhë plehun për dherishte, të zgjedhë dheut, të kryejë plehërimin organik sipas sasisë dhe llojit të përcaktuar më parë në bazë të analizave të tokës, të përziejë sasinë së plehut organik me shtresat e fundme të gropës, të përzgjedhë qeskat e dhura, të bëjë mbushjen e qeskave me dherishte, të bëjë mbjelljen e farës etj.)

Kjo detyrë realizohet në fidanishten (kopështin) e shkollës. Nxënësve u vihen në dispozicion manuale bujqësore dhe pyjore, farishtore, veshjet e domosdoshme, si dhe pajisjet dhe veglat e punës (bel, dhe, pleh organik, kimik, qeska, lopatëza dore, doreza, karroca dore etj.). Nxënësi testohet për përzgjedhjen e materialeve dhe veglave të domosdoshme si dhe për një ose më shumë prej proceseve të punës në mbjelljen e farës. Komisioni vlerësues mbikëqyr nxënësin në proceset konkrete që ai kryen, si dhe zhvillon bashkëbisedim profesional. Nxënësi duhet të vlerësohet në mënyrë individuale dhe instrumenti i vlerësimit duhet të jetë lista e kontrollit, e cila hartohet nga komisioni vlerësues. Kjo listë kontrolli duhet të përmbajë të gjitha hapat dhe elementet e realizimit të kësaj detyre.

Për realizimin e **Detyrës 2**: **“Vlerësimi i një ose më shumë prej proceseve të punës për rrëzimin e drurit sipas procedurës përkatëse”**

Nxënësi vlerësohet në një nga proceset se si: të verifikojë damkën, të përcaktojë drejtimin e rrëzimit, të shënojë bazën e kllapës (vija horizontale e kllapës), të përcaktojë hapësirën e kllapës, të përcaktojë prerjen e rrëzimit (ana e kundërt e kllapës), të përcaktojë zonën e ndërmjetme (zona e sigurisë), të rrëzojë drurin. Nxënësve u vihen në dispozicion katalogë e manuale për shfrytëzimin e pyjeve parcelë pyjore për shfrytëzim.

Nxënësi duhet të vlerësohet në mënyrë individuale dhe instrumenti i vlerësimit duhet të jetë lista e kontrollit, e cila hartohet nga komisioni vlerësues. Kjo listë kontrolli duhet të përmbajë të gjitha hapat dhe elementet e realizimit të kësaj detyre.

Për realizimin e **Detyrës 3**: **“Vlerësimi i një ose më shumë prej proceseve të përcaktimit të llojeve pyjore në zonën e dafinës (Lauretum), karakteristikat morfologjike të tyre”**

Nxënësi vlerësohet në një nga proceset se si: të përcaktojë llojet pyjore në zonën e dafinës, të vrojtojë dhe të evidentojë karakteristikat morfologjike (si, tipi i gjetes, lules dhe frutit), të emërtojë bimët me emrin e familjes, gjinisë dhe species etj.

Kjo detyrë realizohet në kopshtin dendrologjik të shkollës. Nxënësve u vihen në dispozicion katalogë të cilët ndihmojnë në identifikimin e specieve pyjore.

Nxënësi duhet të vlerësohet në mënyrë individuale dhe instrumenti i vlerësimit duhet të jetë lista e kontrollit, e cila hartohet nga komisioni vlerësues. Kjo listë kontrolli duhet të përmbajë të gjitha hapat dhe elementet e realizimit të kësaj detyre.

Për realizimin e **Detyrës 4**: “**Vlerësimi i një ose më shumë prej proceseve të matjes së drurëve me diametër matës dhe hipsometër**”

Në këtë detyrë nxënësi kryen, vlerësohet (një ose më shumë) nga proceset si: përcakton drurët të cilët do të maten, llojin dhe diametër - matësin që do të përdorë, zbaton rregullat e matjes së drurit me diametër - matës, kryen matje të sakta të diametrit, përcakton drurët që do t'u matet lartësia, vendos stadien rrezë të drurit, përcakton largësinë nga vrojtuesi deri tek drurit, përcakton pjerrësinë e sipërfaqes së parcelës si dhe realizon matjet e sakta të lartësisë së drurit etj.

Kjo detyrë kryhet në mjediset (kopështin) e shkollës.

Nxënësi u vihen në dispozicion instrumentet matës të diametrit dhe lartësisë së drurit.

Nxënësi testohet për përzgjedhjen e materialeve dhe veglave të domosdoshme dhe kryen një nga matjet e diametrit dhe të lartësisë së drurit. Komisioni vlerësues mbikëqyr nxënësin në proceset konkrete që ai kryen, si dhe zhvillon bashkëbisedim profesional. Nxënësi duhet të vlerësohet në mënyrë individuale dhe instrumenti i vlerësimit duhet të jetë lista e kontrollit, e cila hartohet nga komisioni vlerësues. Kjo listë kontrolli duhet të përmbajë të gjitha hapat dhe elementet e realizimit të kësaj detyre.

Për realizimin e **Detyrës 5**: “**Vlerësimi i një ose më shumë prej proceseve të kultivimit të bimëve eterovajore**”

Nxënësi vlerësohet në një ose më shumë nga proceset si: (të punojë, të nivelojë tokën, të mbjellë farën eterovajore me shpërndarje, të mbulojë farën me dhe, të përgatisë kalemata, të përgatisë kunjat, të mbjellë, të lidhë kalemata me kunjat etj.).

Kjo detyrë realizohet në fidanishten e shkollës. Nxënësi u vihen në dispozicion: farat, kalemata, veshjet e domosdoshme, si dhe pajisjet dhe veglat e punës (bel, lopatëza dore, doreza, karroca dore, krëhëra etj.).

Nxënësi testohet për përzgjedhjen e materialeve dhe veglave të domosdoshme, dhe një ose më shumë nga proceset e punës për kultivimin e bimëve eterovajore. Komisioni vlerësues mbikëqyr nxënësin në proceset konkrete që ai kryen, si dhe zhvillon bashkëbisedim profesional. Nxënësi duhet të vlerësohet në mënyrë individuale dhe instrumenti i vlerësimit duhet të jetë lista e kontrollit, e cila hartohet nga komisioni vlerësues. Kjo listë kontrolli duhet të përmbajë të gjitha hapat dhe elementet e realizimit të kësaj detyre.